



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1678 Prot.

Tiranë, më datë 13.12.2021

VENDIM
Nr. 663, datë 10.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 10.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit Përfundimtar të Gërmimit Arkeologjik, i realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji “Ad-Star” sh.p.k., në kuadër të projektit “Rruga Lidhëse Bypass Fier - Parku Arkeologjik Apoloni”, Sektori “B” (Km 1+776.80 Km 2+000), me aplikues z. Elfjori Zotaj dhe zhvillues “Autoriteti Rrugor Shqiptar”;
2. Subjekti “Ad-Star” sh.p.k. në bashkëpunim me subjektin “Alb-Buiding” sh.p.k., të realizojë ruatjen e strukturave të zbuluara gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit në Sektorin “B” (Km 1+776.80 Km 2+000), përmes mbulimit të tyre me shtresë zhavorri dhe nivelimit gradual, duke evituar përdorimin e mjeteve mekanike të rënda;
3. Subjekti “Ad-Star” sh.p.k. të marrë masa për përgatitjen e kartelave të objekteve arkeologjike më përfaqësuese dhe t’i depozitojë ato pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Pasurisë Kulturore për regjistrim;
4. Subjekti “Ad-Star” sh.p.k. të marrë masa për përmbushjen e detyrimit ligjor në lidhje me publikimin e rezultateve të gërmimit arkeologjik sipas parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren e Kritereve të Ushtrimit të Profesionit të Arkeologut, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA;
5. Për pjesën tjetër të punimeve të parashikuara në kuadër të këtij projekti, investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin zhvillimor, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;

6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

